

VENDIM
Nr.844, datë 6.12.2011

**PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHITESË NJËSISË BASHKIAKE NR.2 TIRANË, PËR
DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË VIKTIMAVE GENC MEHMET SPAHIU,
FLORIDA NIKO SPAHIU DHE JONA GENC SPAHIU, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
CEREMONISË MORTORE TË VIKTIMAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2011, njësisë bashkiake nr.2, Tiranë t’i akordohet fondi financiar shtesë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme financiare familjes së viktimave Genc Mehmet Spahiu, Florida Niko Spahiu dhe Jona Genc Spahiu, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore të viktimave.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, prefekti i qarkut Tiranë dhe njësia bashkiake nr.2 Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha